



Republika e Kosovës

Republika Kosova-Republic of Kosovo

Qeveria- Vlada- Government

Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal

Ministarstvo Administracije Lokalne Samouprave

Ministry of Local Government Administration

DEPARTAMENTI PËR PERFORMANCË DHE TRANSPARENCË KOMUNALE

DIVIZIONI PËR TRANSPARENCË KOMUNALE

RAPORT I MONITORIMIT TË TRANSPARENCËS KOMUNALE

JANAR- DHJETOR 2020

Prill, 2021



Titulli: Raport i monitorimit të transparencës komunale
Mbikëqyrja: Diellor Gashi, Drejtor i Departamentit për Performancë dhe Transparencë Komunale

Ekipi realizues: Nazmije Krasniqi, Udhëheqëse e Divizionit për Transparencë Komunale
Majlinda Shaqiri, Zyrtare e Lartë për Transparencë Komunale
Kushtrim Tolaj, konsulent nga projekti DEMOS

Viti i botimit: Prill 2021

Publikuar nga: MAPL, Ish-ndërtesa “Rilindja” Kati: 11, 12 dhe 13 Prishtinë, Republika e Kosovës

Të drejtat e autorit © 2021. Ministria e Pushtetit Lokal.

Të gjitha të drejtat janë të rezervuara. Asnjë pjesë e dokumentit nuk mund të kopjohet, shumëzohet dhe të përdoret, në cilën do formë (elektronike dhe fizike) apo të përshkruhet pa lejen me shkrim të autorit - MPL.





TABELA E PËRMBAJTJES

PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE	4
HYRJE	5
PËRMBLEDHJE E LIGJEVE DHE AKTEVE NËNLIGJORE PËR FUSHËN E TRANSPARENCËS KOMUNALE	7
TRANSPARENCA E PUNËS SË KUVENDEVE TË KOMUNAVE	11
PUBLIKIMI I PLANEVE TË PUNËS SË KUVENDEVE	12
TRANSPARENCA NË PUBLIKIMIN E AKTEVE TË KOMUNËS	13
PUBLIKIMI I RAPORTEVE TË KRYETARIT	15
TRANSPARECA FINANCIARE	16
DISKUTIMET PUBLIKE	18
TRANSPARENCA NË PROKURIMIN PUBLIK.....	19
PËRFUNDIME/REKOMANDIME	20





PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE

Viti që e lam pas, mbetet një nga vitet më të vështira të funksionimit të institucioneve në mbarë vendin, për shkak të rrethanave të krijuara nga pandemia Covid-19. Pandemia ndikoi që rrjedha e planifikuar e aktiviteteve të institucioneve publike të ndryshoj, për t'iu përshtatur masave të detyrueshme të qeverisë, me qëllim të koordinimit të mirëfilltë të situatës dhe krijimit të kushteve për lehtësimin e qasjes së qytetarëve në shërbime. Me një fjalë, pandemia ndryshoi ritmin dhe sjelljen e punonjësve në administratë, ashtu që aktiviteti publik në masë të madhe u zëvendësua me punën në distancë. Gjendja e krijuar bëri që përveç reduktimeve të stafit komunal, komunat të kenë edhe shkurtime buxhetore. Kjo ndikoi që një pjesë e madhe e aktiviteteve të planifikuara të pezullohen, në mënyrë që mjetet financiare të destinoheshin për nevoja të menaxhimit të pandemisë. Sidoqoftë, një pjesë e aktiviteteve të parapara të komunave u realizuan, pavarësisht kushteve jo të zakonshme të funksionimit. Në vend të prezencës fizike, punonjësit publik në faza të ndryshme siguruan qasjen online, duke filluar na takimet e kuvendeve komunale, komitetete, takimet me qytetarë, konsultime të tjera me nivelin qendror, e deri tek zhvillimi i procesit mësimor.

Në këto rrethana, informimi publik i qytetarëve ka vazhduar edhe gjatë periudhës në fjalë, duke bërë që komunikimi në mes të institucioneve dhe qytetarëve të jetë i pandërprerë. Krahas mbështetjes së drejtpërdrejtë dhe lehtësimit të komunikimit në mes të nivelit lokal dhe atij qendror, Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal është kujdesur të monitoroj edhe aspekte të transparencës dhe llogaridhënies komunale.

Ky raport analizon dhe vlerëson nivelin e transparencës së 38 komunave të Republikës së Kosovës, duke bërë krahasimin e aktiviteteve të komunave me detyrimet ligjore për informimin e duhur të qytetarëve lidhur me vendimet, planet, dokumentet strategjike, aktivitetet financiare dhe të prokurimit, si dhe përfshirjen e tyre në politikbërje.

Para finalizimit, raporti është dërguar me postë elektronike tek të gjitha komunat për të verifikuar saktësinë e të dhënave të prezantuara.

Të gjeturat e këtij raporti tregojnë për një dallim të dukshëm në mes të numrit të mbledhjeve të mbajtura nga kuvendet e komunave, me njoftimet e publikuara për këto mbledhje në ueb-faqet zyrtare. Në krahasim me 518 mbledhje të mbajtura të kuvendeve të komunave, njoftime në ueb-faqe janë hasur vetëm për 406 mbledhje. Vlen të theksohet se 9 nga gjithsej 28 komuna nuk kanë shpallur asnjë thirrje për mbledhje të kuvendeve të tyre. Në zbatimin e kriterit të publikimit të planeve të punës së kuvendeve komunale, 12 nga gjithsej 38 komuna kanë dështuar të plotësojnë këtë kriter. Sa i përket vendimmarrjes së kryetarëve të komunave, gjatë periudhës Janar-Dhjetor 2020 nga totali i 38 komunave, 29 prej tyre kanë publikuar 3447 vendime të kryetarit, ndërsa 9 komuna nuk kanë publikuar asnjë vendim të kryetarit. Po ashtu, sipas të dhënave të verifikuara, gjatë periudhës Janar-Dhjetor 2020 në ueb-faqet zyrtare të komunave janë publikuar 2968 akte të kuvendeve të komunave në krahasim me 3604 të aprovuara. Në anën tjetër, publikimi i raporteve të kryetarëve të komunave mbetet i ulët, ashtu që 17 komuna ose 45 % e tyre nuk kanë publikuar raportin e kryetarit në ueb faqet zyrtare.





Njëkohësisht, referuar të dhënave të verifikuara, vërehet se 10 komuna ose 26 % nuk kanë bërë publikimin e planeve buxhetore në ueb-faqe. Rezultate më të mira paraqiten tek publikimi i Kornizës Afatmesme Buxhetore, ku 32 komuna kanë publikuar këtë dokument financiar, derisa 6 të tjera apo 16 % kanë dështuar të plotësojnë këtë kriter. Sa i përket publikimit të raporteve tremujore financiare 11 nga 38 komuna nuk kanë publikuar asnjë raport tremujor financiar.

Për dallim nga vitet e mëparshme, në këtë periudhë, pjesëmarrja e qytetarëve në takime publike për diskutime buxhetore paraqitet e ulët, edhe për faktin se 18 komuna nuk kanë organizuar asnjë diskutim buxhetor me publikun. Nga të dhënat e monitorimit vërejmë po ashtu që 8 komuna nuk kanë publikuar asnjë njoftim për takime publike gjithpërfshirëse me qytetarë në ueb-faqet e tyre. Krahas kësaj, 9 komuna kanë dështuar të publikojnë planin vjetor të prokurimit. Megjithatë vlen të theksohet se nga 25 komuna, përmes ueb-faqes zyrtare janë ofruar të dhëna për 1975 aktivitete të prokurimit, derisa 31 komuna kanë publikuar 1942 njoftime për dhënie të kontratave.






Transparenca është një nga aspektet më të rëndësishme në procesin e demokratizimit të shteteve, njëherësh parim kryesor i qeverisjes së mirë. Transparenca është detyrim i autoriteteve qendrore dhe lokale për të ndarë informacione me qytetarët, që nevojiten për të marrë vendime të drejta dhe të bazuara në informacion, si dhe për t'i mbajtur zyrtarët përgjegjës për sjelljen e punën e tyre. Së këndejmi, informimi, përfshirja e qytetarëve në vendimmarrje dhe llogaridhënia janë tri komponentët më me peshë të ushtrimit të pushtetit demokratik. Administrata publike konsiderohet si një ndër sektorët më të rëndësishëm të një shteti, për shkak se është promotor i zhvillimeve dhe ndryshimeve sociale. Qeverisja aktive dhe efektive do të thotë se përtej informimit, qytetarët duhet të dëgjohen dhe të jenë pjesë përbërëse në procesin e politikëbërjes. Autoritetet lokale duhet në vazhdimësi të japin informacione për punën e tyre, të shfrytëzojnë mekanizma për konsultim që përgjigjen më së miri qytetarëve dhe grupet e interesuara, t'i bëjnë ata pjesë të politikë-bërjes, t'u japin llogari në baza të rregullta, si në fazën e planifikimit, ashtu edhe gjatë draftimit dhe zbatimit të këtyre politikave.

Sot me miliona njerëz, në baza ditore varen nga qeveritë e tyre për shërbimet e ofruara. Në funksion të kësaj, cilësia e shërbimeve komunale dhe administrimi efikas i kërkesave të qytetarëve varen edhe nga mënyra e shpërndarjes së informatave, sistemeve të informacionit që aplikohen, teknologjitë, teknikave të konsultimit, si dhe veprimeve të tjera përcjellëse të organeve të administratës publike.

Përdorimi i ueb-faqeve është një nga mekanizmat për të mbajtur të informuar qytetarët lidhur me aktivitetet e organeve komunale. Përdorimi i tyre rregullohet me akt nënligjor të qeverisë, i cili i obligon të gjitha institucionet publike të japin informacionet për punën e organeve të tyre, shërbimeve të ofruara, përmbajtjes dhe përditësimit të dokumenteve zyrtare, informacioneve për përgjegjësitë e njësive organizative të komunave, dokumenteve financiare, prokurimit etj. Po ashtu, informacioni i publikuar në ueb faqe duhet të jetë në përputhje me kërkesat dhe standardet gjuhësore.

Në vitin 2018, Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal ka ri-dizajnuar ueb-faqet e 38 komunave. Ri-dizajnimi mundësoi unifikimin e standardeve të publikimit të informatave, dhënien e mundësisë për aplikim online për leje ndërtimore, paraqitjen e kërkesave dhe shqetësimeve në fushën e sigurisë në bashkësi, si dhe transmetimin online të mbledhjeve të kuvendeve të komunave (KK). Përveç karakterit informues të ueb-faqeve komunale, ato mundësojnë edhe procese administrative dhe ndërlidhen me ueb-faqe tjera të cilat shërbejnë për procesin e konsultimit publik. Ndërlidhja e tyre me sistemin e intranetit në komunë u mundëson qytetarëve të parashtrajnë online të gjitha kërkesat e tyre drejtorive përkatëse të komunës.





PËRMBLEDHJE E LIGJEVE DHE AKTEVE NËNLIGJORE PËR FUSHËN E TRANSPARENCËS KOMUNALE

Departamenti për Performancë dhe Transparencë komunale në kuadër të Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal, me theks të veçantë Divizioni për Transparencë Komunale ka në përgjegjësi monitorimin e transparencës së komunave dhe zhvillimin e politikave në këtë fushë. Korniza ligjore që rregullon aspekte të ndryshme të transparencës së institucioneve publike, me fokus tek komunat përfshinë: Kushtetutën e Republikës së Kosovës, Ligjin Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale, Ligjin Nr. 06/L-081 për Qasje në Dokumente Publike, Rregulloren (QRK) Nr. 27/2018 për Shërbimin e Komunikimit Qeveritar me Publikun, Rregulloren (QRK) Nr.04./2012 për Evidencën Zyrtare të Kërkesave për qasje në dokumente publike, Rregulloren (MAPL) Nr. 01/2017 për Procedurën e Hartimit dhe Publikimit të akteve të Komunës, Udhëzimin Administrativ (MAPL) Nr.06/2018 për Standardet Minimale të Konsultimit Publik në Komuna, Udhëzimin Administrativ (MAPL) Nr.03/2020 për Transparencën në Komuna dhe Udhëzimin Administrativ Nr.01/2015 për Ueb-Faqet e Institucioneve Publike. Në vijim është paraqitur një përmbledhje për secilin nga aktet ligjore të përmendura më lartë:

Kushtetuta e Republikës së Kosovës

Kushtetuta përcakton parimet themelore të vetëqeverisjes lokale. Neni 123, paragrafi 4 përcakton një numër parimesh që shërbejnë si baza të forta për krijimin dhe funksionimin e vetëqeverisjes lokale. Përpos transparencës, ajo përfshijnë parimet e qeverisjes së mirë, efikasitetit dhe efektivitetit në sigurimin e shërbimeve publike duke pasur parasysh nevojat specifike dhe interesat e komuniteteve jo-shumicë dhe anëtarëve të tyre. Sa i përket transparencës, Neni 41 i Kushtetutës garanton të drejtën e qytetarëve për qasje në dokumentet e institucioneve publike dhe të organeve të pushtetit shtetëror. Në frymën e Kushtetutës, më tej janë hartuar dhe miratuar një numër i akteve ligjore dhe nën-ligjore me të cilat përcaktohen të drejtat e qytetarëve në procese me interes publik, jo vetëm në nivel qendror por edhe atë lokal.

Ligji Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale

Në përputhje me parimet e Kushtetutës së Republikës së Kosovës, Kartës Evropiane të Vetëqeverisjes Lokale, Kuvendi i Republikës së Kosovës ka miratuar Ligjin për Vetëqeverisjen Lokale, i cili shërben si ligj themelor për organizimin dhe funksionimin e vetëqeverisjes lokale në Kosovë. Ligji përcakton bazën ligjore për një sistem të qëndrueshëm të vetëqeverisjes lokale në Kosovë dhe përcakton statusin ligjor të komunave, kompetencat e tyre dhe parimet e përgjithshme të financave komunale, organizimin dhe funksionimin e organeve komunale, rregullimet ndër-komunale dhe bashkëpunimin ndër-komunal duke përfshirë bashkëpunimin ndër-kufitar dhe marrëdhëniet





ndërmjet komunave dhe qeverisë qendrore.¹ Për më tepër, Neni 68 i këtij Ligji përcakton se “çdo komunë mban periodikisht, së paku dy herë në vit, takime publike në të cilat mund të marrë pjesë secili person apo organizatë me interes në komunë. Data dhe vendi i takimit publikohet së paku dy javë përpara. Njëra nga mbledhjet mbahet gjatë gjashtë muajve të parë të vitit. Ky Ligj parasheh po ashtu se Kuvendi i komunës miraton rregulloren komunale që promovon transparencë të organeve legjislative, ekzekutive dhe administrative të komunës, duke e rritur pjesëmarrjen e publikut në marrjen e vendimeve në nivel lokal dhe duke lehtësuar qasjen publike në dokumentet zyrtare të komunës. Me anë të këtij Ligji përcaktohet se Ministria përgjegjëse për qeverisjen lokale nxjerrë udhëzime administrative për transparencë komunale.

Ligji Nr. 06/L-081 për Qasje në Dokumente Publike

Ligji për Qasje në Dokumente Publike është korniza esenciale ligjore me të cilin synohet të arrihen standardet dhe praktikat më të avancuara ndërkombëtare të transparencës. Ky ligj garanton të drejtën e secilit person në Kosovë që pa diskriminim mbi çfarëdo baze, për të pasur qasje në dokumente publike, të prodhuara, pranuar, mbajtura apo kontrolluara nga institucionet publike, si dhe të drejtën për ripërdorimin e dokumenteve të sektorit publik.² Me këtë ligj rregullohen të gjitha procedurat duke filluar nga trajtimi i kërkesave të qytetarëve për qasje në dokumente publike, përpunimi i kërkesave dhe lejimi i qasjes në dokumente publike.

Rregulloren (QRK) Nr. 27/2018 për Shërbimin e Komunikimit Qeveritar me Publikun

Me këtë Rregullore përcaktohet funksionimi i një sistemi koherent dhe të koordinuar për komunikimin qeveritar me publikun, dispozitat e të cilës janë të detyrueshme si për nivelin qendror edhe atë lokal të qeverisjes. Sa i përket nivelit komunal, kjo Rregullore, rëndësi të veçantë i jep zyrtarit përgjegjës për komunikim publik në komuna duke përcaktuar një mori të detyrave dhe përgjegjësive me qëllim të informimit sa më të mirë të publikut me punën e komunës.³ Më tutje, sipas kësaj Rregulloreje, komunat janë të detyruara të përdorin rrjetet sociale për informim të publikut lidhur me punën e tyre dhe t’u ofrojnë mediave qasje në përcjelljen e aktiviteteve në kompetencë të komunave.

Rregullore (QRK) Nr.04./2012 për Evidencën Zyrtare të Kërkesave për qasje në dokumente publike

Duke pasur si bazë ligjore Ligjin për Qasje në Dokumentet Publike, Rregullorja Nr.04./2012 për Evidencën Zyrtare të Kërkesave për qasje në dokumente publike përcakton përmbajtjen e evidencës zyrtare, përkitazi me kërkesat, veprimet, procedurat dhe vendimet, lidhur me realizimin e të drejtave të personave fizik dhe juridik, në qasje në dokumente publike. Dispozitat e kësaj

¹ Ligji Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale), Neni 1 dhe Neni 3, paragrafi 2.1, mund të gjendet në: <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=2530>

² Ligji Nr. 06/L-081 për Qasje në Dokumente Publike, Neni 1, mund të gjendet në: <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=20505>

³ Rregullorja (QRK) Nr. 27/2018 për Shërbimin e Komunikimit Qeveritar me Publikun, neni 13, mund të gjendet në: <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=18380>





Rregulloreje janë të detyrueshme për të gjitha institucionet publike dhe organet e pushtetit shtetëror si dhe për të gjitha dokumentet publike që mbahen, hartohen apo pranohen nga institucionet publike.⁴ Tutje, kjo Rregullore përcakton kriteret për mbajtjen e regjistrit për kërkesat për qasje në dokumente publike, përgjegjësitë dhe afatet për raportim, përmbajtjen e raportit etj.

Rregullore (MAPL) Nr. 01/2017 për Procedurën e Hartimit dhe Publikimin e akteve të Komunës

Kjo Rregullore përcakton unifikimin e teknikës juridike, strukturës dhe procedurës së hartimit, si dhe publikimit të akteve të komunës,⁵ dhe dispozitat e saj janë të detyrueshme për të gjitha organet e komunës që hartojnë, miratojnë dhe publikojnë aktet e tyre. Në vijim, kjo Rregullore shtjellon aktet që nxirren nga komunat siç janë Statuti i Komunës, rregulloret, vendimet, marrëveshjet e bashkëpunimit ndërmjet komunave dhe aktet tjera që parashihen me ligje të tjera.⁶ Tutje, Rregullorja përcakton parimet e hartimit të akteve të komunës, strukturën e akteve normative të komunës, shtojcat, shfuqizimin dhe plotësim-ndryshimin e akteve normative të komunës, propozuesit e akteve normative, procesin e hartimit, nënshkrimin dhe publikimin i akteve normative në ueb faqen e komunës etj.

Udhëzimi Administrativ (MAPL) Nr.06/2018 për Standardet Minimale të Konsultimit Publik në Komuna

Ky Udhëzim Administrativ ka për qëllim nxitjen dhe sigurimin nga ana e autoriteteve lokale të pjesëmarrjes së qytetarëve dhe palëve të tjera të interesuara gjatë procesit të politikë-bërjes dhe vendimmarrjes në nivel lokal, të promovoj transparencë komunale, si dhe të ndikoj në zhvillimin e politikave të qëndrueshme në interes të përgjithshëm dhe përcakton rregullat, parimet, format, procedurat dhe standardet minimale të konsultimit publik në komuna me rastin e zhvillimit të politikave dhe akteve nënligjore të komunës.⁷

Udhëzimi Administrativ (MAPL) Nr.03/2020 për Transparencën në Komuna

Qëllimi i këtij Udhëzimit Administrativ është fuqizimi i transparencës së organeve komunale përmes informimit dhe publikimit real të akteve, vendimeve e dokumenteve tjera të komunës si dhe ngritja e pjesëmarrjes së qytetarëve në vendimmarrje.⁸ Tutje, në Udhëzim rregullohen mbajtja dhe publiciteti i takimeve të Kuvendit të Komunës dhe komiteteve, transparenca e vendimeve komunale, transparenca financiare dhe aktivitetet e prokurimit, qasja në dokumentet publike,

⁴ Rregullorja Nr.04./2012 për Evidencën Zyrtare të Kërkesave për qasje në dokumente publike, Nenet 1 dhe 2, mund të gjendet në: <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=8355>


⁵ Rregulloren (MAPL) Nr. 01/2017 për Procedurën e Hartimit dhe Publikimin e akteve të Komunës, Neni 1, mund të gjendet në: <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=15184>

⁶ Id. Neni 4, paragrafi 1

⁷ Udhëzimi Administrativ (MAPL) Nr.06/2018 për Standardet Minimale të Konsultimit Publik në Komuna, Neni 1, mund të gjendet në: <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=18425>

⁸ Udhëzimin Administrativ (MAPL) Nr.03/2020 për Transparencën në Komuna, Neni 1, mund të gjendet në: <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=31852>





kërkesat për informim , iniciativat qytetare dhe peticionet, takimet me qytetar, konsultimi i publikut para miratimit të akteve etj.


Udhëzimi Administrativ Nr.01/2015 për Ueb-Faqet e Institucioneve Publike

Ky Udhëzim Administrativ përcakton standardet për formën, përmbajtjen minimale, pamjen vizuale, dhe karakteristikat tjera që duhet të kenë të gjitha ueb faqet e institucioneve publike⁹ dhe zbatohet për të gjitha institucionet publike,¹⁰ pra duke përfshirë edhe komunat. Në vazhdim, Udhëzimi rregullon qasjen e drejtpërdrejt në informata publike në formë elektronike, emërtimin e ueb-faqes, shfletimin dhe qasjen në ueb faqe, hostimin, platformë, përmbajtjen dhe sigurinë e ueb-faqeve, modulin e kërkimit, gjuhë, lidhjen përmes vegëzave në Databazën e Gazetës Zyrtare të Republikës së Kosovës, si dhe redaktimin dhe përditësimin dhe mbikëqyrjen etj.

⁹ Udhëzimi Administrativ Nr.01/2015 për Ueb-Faqet e Institucioneve Publike, Neni 1, mund të gjendet në: <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=11007>

¹⁰ Id. Neni 2





TRANSPARENCA E PUNËS SË KUVENDEVE TË KOMUNAVE

Kuvendi i Komunës është organi më i lartë përfaqësues i pushtetit lokal dhe njëkohësisht organ i autorizuar ligjërisht për mbikëqyrjen e ofrimit të shërbimeve nga ekzekutivi i komunës në përputhje me legjislacionin në fuqi. Për të ushtruar funksionin e tij, kuvendi i komunës duhet të mbledhet rregullisht në mënyrë që të kryej përgjegjësitë në kuadër të kompetencave ligjore komunale, për të miratuar aktet e nevojshme normative për funksionimin e komunës, akte të cilat kërkohen shprehimisht me legjislacionin në fuqi apo ato të cilat ligjet i lënë të hapura për tu nxjerrë varësisht nga nevojat e komunave, si dhe për të diskutuar dhe vendosur çështjet me interes të komunës.

Korniza ligjore për vetëqeverisje lokale në Republikën e Kosovës ka përcaktuar disa kritere në lidhje me zhvillimin e aktiviteteve të organeve komunale në mënyrë transparente apo të hapur. Para çdo mbledhje të kuvendit, kryesuesi obligohet që së paku 7 ditë pune para mbledhjeve të rregullta dhe 3 ditë pune para mbledhjeve të jashtëzakonshme, si dhe brenda ditës në rastet e mbledhjeve urgjente të njoftojë publikun përmes shpalljes së njoftimit në ueb-faqen zyrtare të komunës, rrjeteve sociale apo mediave.

Sipas të dhënave nga monitorimi i komunave ekziston dallim i dukshëm në mes të numrit të mbledhjeve të mbajtura të kuvendeve me njoftimet e publikuara në ueb-faqe. Në krahasim me 518 mbledhje të mbajtura të kuvendeve të komunave, njoftime në ueb-faqe janë hasur për 406 mbledhje. Në grafikun e mëposhtëm është paraqitur publikimi i thirrjeve dhe mbajtja e mbledhjeve të Kuvendit për secilën komunë.




Fig. 1 Krahasimi në mes të mbledhjeve të mbajtura dhe njoftimeve të shpallura në ueb-faqe, Janar-Dhjetor 2020





Nga figura e mësipërme vërehet se 9 komuna nuk kanë shpallur asnjë thirrje për mbledhje të kuvendeve të tyre në ueb-faqet zyrtare.¹¹ Në anën tjetër, 29 komuna kanë qenë plotësisht të përgjegjshme në publikimin e njoftimeve për mbledhje të kuvendeve. Për më tepër gjatë monitorimit është vërejtur se nuk aplikohet standard i njëjtë i publikimit të thirrjeve në ueb-faqe, pasi që komunat përdorin rubrika të ndryshme të lansimit të njoftimeve duke shkaktuar vështirësi në qasje në informata. Komunat duhet të përmirësojnë mënyrën e publikimit të dokumenteve sipas çështjeve tematike si dhe të respektojnë plotësisht dispozitat ligjore në këtë fushë.

PUBLIKIMI I PLANEVE TË PUNËS SË KUVENDEVE

Si çdo institucion tjetër edhe kuvendet e komunave planifikojnë agjendën e tyre vjetore në përputhje me objektivat e strategjike të komunës. Planet e punës përcaktojnë objektivat e kuvendeve, aktivitetin normativ njëvjeçar, kalendarin e takimeve, mënyrën e zhvillimit të aktiviteteve, marrëdhëniet me ekzekutivin, komunikimin me publikun, zhvillimin e kapaciteteve të anëtarëve të kuvendit, shqyrtimin e inicitativave të qytetarëve dhe çështje të tjera në kudër të fushëveprimit të tyre. Publikimi i planeve vjetore të punës është i obligueshëm në bazë të udhëzimit administrativ për transparencë, si dhe në bazë të kriterëve të mirëmbajtjes së ueb-faqeve zyrtare të institucioneve publike.¹²

Publikimi i planit të Kuvendit të Komunës




Fig. 2 Krahasimi i publikimit të Planeve të Punës së Kuvendeve në ueb-faqe, Janar-Dhjetor 2020

Nga grafiku i mësipërm, nga gjithsej 38 komuna, vërehet se vetëm 26 komuna kanë publikuar planet e punës së kuvendeve në ueb-faqet e tyre, ndërsa 12¹³ komuna kanë dështuar të plotësojnë këtë kriter. Komunat duhet të shtojnë intensitetin e punës së tyre në bërjen sa më transparente të aktiviteteve të zhvilluara dhe dokumenteve publike. Në demokracitë e tërthorta, përfshirja e

¹¹ Gracanica, Junik, Partesh, Podujeve, Shterpcë, Zubin Potok, Zecan, Leposaviq, Mitrovica Veriore

¹² Udhëzimi Administrativ (MAP) Nr.01/2015 për ueb-faqet e institucioneve publike, neni 9

¹³ Decan, Klllokot, Novoberrde, Obiliq, Partesh, Ranillug, Shterpcë, Zubin Potok, Leposaviq, Mitrovica Veriore, Mamushë





qytetarëve duhet parë si një mjet të rëndësishëm për legjitimimin e politikave publike. Komunitat duhet të krijojnë mekanizma ligjor, që qytetarëve t'u mundësojë të jenë sa më afër bazës së informacionit. Format e shumta të konsultimit dhe përfshirjes së qytetarëve jetësojnë konceptin qytetarisë aktive dhe ndërtojnë qeverisjen e opinionit publik. Si rrjedhojë, pikëpamjet e ndryshme të publikut japin mundësinë e vërtetimit të supozimeve të administratës, duke zhvilluar politika të bazuara në argumente, dëshmi dhe fakte reale. Ky nivel i përfshirjes kërkohet të fillojë që në procesin e planifikimit operacional për ta bërë administratën më funksionale. Planifikimi operacional mund të jetë efektiv vetëm atëherë kur është i ndërtuar në mënyrë të tillë që qëllimi dhe objektivat e agjencisë përfshihen dhe adresohen përmes një sistemi apo plani operativ.

TRANSPARENCA NË PUBLIKIMIN E AKTEVE TË KOMUNËS

Transparenca është një ndër parimet themelore të vetëqeverisjes lokale përmes të cilës komunitat duhet të bëjnë publike aktivitetet e tyre me qëllim të informimit të qytetarëve për punën e administratës. Qasja e lirë në informacion luan një rol kyç në promovimin e transparencës dhe në parandalimin e korrupsionit. Institucionet shtetërore duhet të ofrojnë informacionin e nevojshëm në kohë dhe në mënyrë të plotë për qytetarët, me qëllim që të garantojnë përdorim sa më efektiv të tij.

Publikimi i akteve është rregulluar me ligjin për vetëqeverisje lokale dhe akte të tjera nënligjore. Sipas udhëzimit Administrativ për Transparencën në komuna, publikimi në ueb-faqen zyrtare të komunës i akteve normative me karakter të përgjithshëm është i obligueshëm, si dhe vendimeve të kryetarit që ndikojnë drejtpërdrejt në interesat e qytetarëve.

Sa i përket vendimmarrjes së kryetarëve të komunave, gjatë periudhës Janar-Dhjetor 2020 nga totali 38 i komunave të Republikës së Kosovës, 29 komuna kanë publikuar 3447 vendime të kryetarit, ndërsa 9¹⁴ komuna nuk kanë publikuar asnjë vendim të kryetarit. Publikimi i akteve të kryetarëve në bazë përqindjes së komunave është paraqitur në grafikun më poshtë:

¹⁴ Gjilan, Junik, Novobërdë, Partesh, Ranillug, Shtërpcë, Zubin Potok, Leposaviq, Mitrovicë Veriore





Figure 2 Publikimi i akteve të kryetarëve

Veç shpërndarjes së informatave lidhur me punën e administratës, komunat duhet të sigurojnë përmbushjen e kushteve të tjera procedurale për publikimin e akteve të kuvendeve të komunave në ueb-faqe, nga ku edhe rrjedh afati për hyrjen në fuqi të tyre. Publiciteti i vendimeve ndikon në përmbushjen e standardeve të performancës së komunave në fushën e transparencës komunale, duke ndikuar edhe në lartësinë e grantit të performancës të ndarë për komuna sipas kriterëve të veçanta. Gjithashtu, publiciteti adreson edhe vërejtjet e njëpasnjëshme të paraqitura në raportet e Komisionit Evropian për Vendin ku theksohet nevoja për rritjen e transparencës së administratës publike në nivel lokal. Referuar të dhënave, vërehet që akoma kërkohet angazhim i strukturave përgjegjëse komunale për përmbushjen e plotë të standardeve të publikimit të akteve pas aprovimit.

Sipas të dhënave, gjatë periudhës Janar-Dhjetor 2020 në ueb-faqet zyrtare të komunave janë publikuar 2968 akte të Kuvendeve të komunave në krahasim me 3604 të aprovuara, apo 82% të publikuara.

Të dhënat për miratimin dhe publikimin të akteve të kuvendeve sipas komunave është paraqitur në grafikun më poshtë:

82%

E akteve të kuvendeve të publikuara






Fig. 3 Diferenca në mes të akteve të miratuara nga kuvendet me aktet e publikuara në ueb-faqe

Nga këto të dhëna vërejmë se nga gjithsej 38 komuna, vetëm 4¹⁵ komuna nuk kanë publikuar asnjë akt të miratuar gjatë periudhës Janar-Dhjetor 2020.


PUBLIKIMI I RAPORTEVE TË KRYETARIT

Nga aspekti i mbikëqyrjes, legjislacioni ka përcaktuar mundësitë e kontrollit që kryen kuvendi i komunës ndaj ekzekutivit dhe kontrollin e administratës nga kryetari i komunës. Kontrolli që kuvendi ushtron ndaj ekzekutivit dhe kryetarit, mundësohet përmes një numër mekanizmesh ligjor. Kuvendi ka të drejtën për të kërkuar “raporte dhe llogari nga kryetari i komunës për situatën ekonomike-financiare dhe zbatimin e planeve investuese, së paku një herë në 6 muaj, apo kurdoherë që kërkohet nga kuvendi”.¹⁶ Krahas raportimit me prezencë të kryetarit në kuvendin e komunës, prezantimi i raporteve të punës është mjet kryesor i kontrollit që duhet të formalizohet. Në bazë të udhëzimit administrativ për transparencë, raportet e kryetarit duhet të publikohen në ueb-faqen e komunës bashkë me dokumentet e tjera të obligueshme. Publikimi i raporteve të kryetarit është po ashtu tregues i vendosur në Sistemin për Menaxhimin e Performancës Komunale.

¹⁵ Zubin Potok, Zvečan, Leposaviq, Mitrovicë e Veriut

¹⁶ Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës / Prishtinë: viti iii / Nr. 28 / 04 Qershor 2008, Ligji Nr.03 L-040 për Vetëqeverisje Lokale, neni 58, pika j





Megjithëkëtë, të dhënat e fituara nga monitorimi i ueb-faqeve tregojnë se komunat nuk qëndrojnë mirë në publikimin e raportit të kryeartit të komunës. Gjatë periudhës janar-dhjetor 2020 vetëm 21 komuna ose 55 % e tyre kanë publikuar raportin e kryetarit të komunës, ndërsa 17 komuna ose 45 % nuk kanë publikuar këtë raport.

TRANSPARECA FINANCIARE

Transparenca financiare është një nga kriteret kryesore të qeverisjes së mirë që ndikon në rritjen e llogaridhënies së organeve komunale para qytetarëve. Rëndësia e transparencës ndikon në aspekte të shumta duke përfshirë qëndrueshmërinë ekonomike, financiare, qeverisjen e mirë, si dhe në sistemin e përgjithshëm të administratës shtetërore. Përmes këtij parimi mundësohet hapja e administratës para shoqërisë, informimi për punën e saj mund të bëhet në mënyrë të ndryshme dhe në vëllim të ndryshëm, parim që mund të kufizohet vetëm në rastet e caktuara në legjislacionin e secilit vend. Transparenca financiare bënë që administrata të e jetë qasshme 'nga jashtë' dhe se çdo kush ka të drejtë të dijë arsyet që kanë sjellë deri te një vendim i caktuar ose veprim i administratës.

Për këtë arsye, ueb-faqet zyrtare të institucioneve publike janë platformat bazë dhe më të aplikueshmet për komunikimin e informatave për qytetarë, dhënie e informacioneve për fushëveprimin e tyre, menaxhimit financiar, aktivitete të prokurimit, si dhe qasje në dokumente publike.

Lidhur me dokumentet financiare komunat janë të obliguara t'i bëjnë publike planet vjetore buxhetore, Kornizën afatmesme të shpenzimeve, njoftimet për dëgjime buxhetore, raportet 3 mujore financiare, raportet e auditimit etj.

Referuar të dhënave të ueb-faqeve të komunave del që vetëm 28 komuna ose 74 % e tyre kanë bërë publikimin e planeve buxhetore në pajtim me paragrafin 1 të nenit 6 të Udhëzimit Administrativ për Transparencë.





Plani buxhetor i vitit 2020 i publikuar në ueb-faqe

28

Deçan, Ferizaj, Fushë Kosovë, Gjakovë, Gjiilan, Graçanicë, Hani i Elezit, Istog, Junik, Kamenicë, Kaçanik, Klinë, Klllokot, Lipjan, Malishevë, Mitrovicë e Jugut, Obiliq, Pejë, Podujevë, Prishtinë, Prizren, Rahovec, Skenderaj, Suharekë, Vushtrri, Mamushë, Dragash

Plani buxhetor i papublikuar

10

Novobërdë, Partesh, Ranillug, Shtime, Shtërpçë, Viti, Zubin Potok, Zveçan, Leposaviq, Mitrovicë Veriore

Në përgjithësi komunat qëndrojnë më mirë në publikimin e Kornizës Afatmesme Buxhetore (KAB). Sipas të dhënave 32 komuna apo 84 % e tyre kanë bërë publik në ueb-faqe këtë dokument financiar, derisa nuk është publikuar nga 6 komuna apo 16% e tyre.

Në vijim është paraqitur grafiku i publikimit të KAB-it në ueb-faqet zyrtare të komunave:

KAB i vitit 2020 i publikuar në ueb-faqe

32

Deçan, Ferizaj, Gjakovë, Gjiilan, Graçanicë, Hani i Elezit, Istog, Junik, Kamenicë, Kaçanik, Klinë, Klllokot, Lipjan, Malishevë, Mitrovicë e Jugut, Obiliq, Partesh, Pejë, Podujevë, Prishtinë, Prizren, Rahovec, Ranillug, Shtime, Skenderaj, Suharekë, Viti, Vushtrri, Mamushë, Dragash

KAB i vitit 2020 i papublikuar në ueb-faqe

6

Fushë Kosovë, Novobërdë, Shtërpçë, Zubin Potok, Zveçan, Leposaviq, Mitrovicë Veriore

Krahas dokumenteve të planifikimit buxhetor, legjislacioni në fuqi i obligon komunat të bëjnë publike veprimtarinë e tyre financiare. Publikimi i raporteve periodike financiare lehtëson edhe aspektet e tjera të kontrollit të jashtëm për të vlerësuar efikasitetin e punës së kuvendeve të komunave, respektimin e ligjshmërisë, menaxhimin efikas financiar si dhe performancën e përgjithshme të ekzekutivit të komunës. Neni 45.4 i Ligjit për menaxhimin e financave publike dhe përgjegjësi ka përcaktuar që kryetari i komunës përveç se obligohet t'i përgatis raportet 3 mujore financiare, të njëjtat duhet t'i publikoj në ueb-faqen e komunës. Ne vijim është paraqitur figura me të dhënat për komunat që kanë publikuar raportet financiare tremujore dhe ato të cilat nuk i kanë publikuar:

Numri i komunave të cilat i kanë publikuar raportet tremujore financiare

29

Deçan, Ferizaj, Gjiilan, Glllogoc, Graçanicë, Hani i Elezit, Junik, Kamenicë, Kaçanik, Klinë, Lipjan, Malishevë, Mitrovicë e Jugut, Obiliq, Pejë, Podujevë, Prishtinë, Prizren, Rahovec, Shtime, Shtërpçë, Skenderaj, Suharekë, Viti, Vushtrri, Dragash

Numri i komunave të cilat nuk i kanë publikuar raportet tremujore financiare

11

Fushë Kosovë, Gjakovë, Istog, Klllokot, Novobërdë, Partesh, Ranillug, Zubin Potok, Zveçan, Leposaviq, Mitrovicë Veriore, Mamushë






Referuar nenit 46 të ligjit për menaxhimin e financave publike dhe përgjegjësi, kryetari i komunës “Kryetari i komunës duhet të përgatitë dhe t’i dorëzojë kuvendit komunal një raport përfundimtar përmbledhës buxhetor i cili përmban të dhënat e përcaktuara në nenin 46.1, sikur që aplikohen ato për komunën përkatëse”. Lidhur me këtë, deri më tani komunat nuk kanë publikuar raportin buxhetor për vitin 2020 në ueb-faqet e tyre.

DISKUTIMET PUBLIKE

Në nivelin lokal mekanizmi i pjesëmarrjes së qytetarëve në bërjen e politikave është parim bazë i demokracisë së drejtpërdrejtë. Shumë shtete këtë parim demokratik e kanë inkorporuar në ligjet e tyre duke i kushtuar vëmendje zbatimit të saj me qëllim të përfshirjes së qytetarëve në vendimmarrje dhe fuqizimit të transparencës në qeverisje. Komunat janë të obliguara të vënë në funksion standarde të ndryshme të konsultimit me qytetarë. Komunikimi ndodh përmes takimeve të drejtpërdrejta, informimit publik, përfshirjes aktive të qytetarëve, grupeve të interesit, tryezave të përbashkëta, përdorimit të sistemeve elektronike të informacionit, si dhe çfarëdo metode tjetër me të cilën transparenca do të ndikojë në avancimin e vetëqeverisjes lokale. Këto praktika duhet të gjejnë vend si në procesin e draftimit të buxhetit si dokument kryesor strategjik i komunës, ashtu edhe në diskutime për çështje të rëndësishme publike, zbatimit të projekteve, planeve si dhe projektakteve komunale. Përkundër rëndësisë së këtij procesi, të dhënat statistikore tregojnë se pjesëmarrja e qytetarëve nuk është në nivelin e kënaqshëm. Në përgjithësi arsyet e pjesëmarrjes së ulët lidhen me mosinformimin e duhur të qytetarëve, mosaplikimin e formave dhe teknikave adekuate për informim, mungesës së zbatimit të plotë të standardeve minimale të konsultimit publik respektivisht publikimit të raporteve për rezultatet e konsultimeve publike si dhe formave të tjera të komunikimit me qytetarë. Për dallim nga vitet e mëparshme, në këtë periudhë, pjesëmarrja e qytetarëve nuk ka qenë e mundur për shkak të kufizimeve si pasojë e pandemisë Covid-19. Sipas të dhënave gjatë kësaj periudhe takime publike me qytetarë për nevoja të diskutimeve buxhetore u organizuan nga 20 komuna gjithsej sic është paraqitur në grafikun më poshtë:



Komunat po ashtu kanë mbajtur edhe takime të tjera të karakterit gjithëpërfshirës të cilat organizohen nga komuna në baza vjetore sipas nenit 68.1 të LVL-së si dhe takime të tjera për projektakte dhe politika zhvillimore. Në total në ueb-faqet e komunave janë publikuar 30 njoftime për takime publike me qytetarë gjatë kësaj periudhe, si vijon:





Njoftimet për takime publike




Fig. 5 Numri i ftesave për takime publike me qytetarë të publikuara në ueb-faqet e komuanve

Nga përshkrimet ne grafikun e mësipërm vërejmë që 8 komuna nuk kanë publikuar njoftime për takime publike me qytetarë në ueb-faqet e tyre, ndërsa 30 nga komunat kanë bërë publikimin e njoftimeve për takime me qytetarë. Në këtë pjesë nuk janë përfshirë takimet publike që ndërlidhen me diskutimet buxhetore. Ky proces i monitorimit ka konstatuar se komunat nuk ndjekin një strukturë unike dhe të standardizuar për publikimin e njoftimeve për takime me qytetarë. Madje pjesa më e madhe e tyre nuk kanë një ‘meny’ të veçantë në ueb-faqet e tyre për diskutimet publike, gjë që mund të shkaktoj pengesa të qasjes me kohë në informatat të cilat publikohen nga komunat.

TRANSPARENCA NË PROKURIMIN PUBLIK

Prokurimi publik është ndër proceset më të ndjeshme për secilën organizatë buxhetore, për të cilën kërkohet transparencë dhe llogaridhënie e plotë sipas rregullave ligjore. Autoritetet komunale janë të obliguara me ligj që të përpilojnë një plan të prokurimit ku duhet të planifikojnë projektet, shërbimet si dhe kostot për këto secilin projekt e shërbim në këtë plan. Plani i prokurimit komunal duhet të përpilohet dhe publikohet në tre muajt e parë të vitit. Po ashtu, komunat si autoritete kontraktuese në bazë të Rregullave dhe Udhëzuesit Operativ për Prokurim Publik nga KRPP duhet të ofrojnë informata për Njoftimet për kontratë, njoftimet për anulime të aktiviteteve të prokurimit si dhe Njoftimet e Dhënies së Kontratave/Njoftimet e Rezultateve të Konkursit të Projektimit pavarësisht nga lloji apo vlera e parashikuar. Po ashtu komuna në muajin janar të vitit vijues e publikon raportin vjetor për realizimin e planit të prokurimit publik në komunën përkatëse për vitin paraprak. Referuar të dhënave 29 komuna kanë publikuar planin vjetor të prokurimit publik, ndërsa 9 komuna nuk e kanë publikuar.

Komunat që e kanë publikuar planin vjetor të prokurimit

29

Deçan, Ferizaj, Gjakovë, Gjilan, Glllogoc, Graçanicë, Hani i Elezit, Istog, Junik, Klinë, Kamenicë, Lipjan, Mitrovicë e Jugut, Malishevë, Novobërdë, Obiliq, Pejë, Podujevë, Prishtinë, Prizren, Rahovec, Shtime, Shtërpcë, Skenderaj, Suharekë, Viti, Vushtrri, Mamushë, Dragash

Komunat që nuk e kanë publikuar planin vjetor të prokurimit

9

Fushë Kosovë, Kaçanik, Kllokot, Partesh, Ranillug, Zubin Potok, Zveçan, Leposaviq, Mitrovicë Veriore

Nga 25 komuna, përmes ueb-faqes zyrtare janë ofruar të dhëna për 1975 aktivitete të prokurimit, derisa 31 komuna kanë publikuar në ueb-faqet e tyre 1942 njoftime për dhënie të kontratave.





PËRFUNDIME/REKOMANDIME

- Në bazë të analizës së të dhënave të paraqitura në këtë raport, vihet re se transparencja në disa komuna në Republikën e Kosovës, ka shënuar avancim të dukshëm. Megjithatë në disa nga komunat si p.sh. Novobërda, Partesh, Ranillug, Mamushë, e posaçërisht në Zubin Potok, Zveçan, Leposaviq dhe Mitrovicë Veriore vërehet ngecje më e theksuar në zbatimin e kornizës ligjore për transparencë.
- Komunat duhet të shtojnë kujdesin e tyre në njoftimin paraprak të palëve të interesit për mbajtjen e mbledhjeve të kuvendeve të komunave. Për këtë qëllim njoftimet duhet të bëhen publike në çdo rast përmes ueb-faqeve zyrtare të komunave, si dhe kanaleve të tjera informative.
- 12 komuna të cilat nuk kanë publikuar planet e punës së kuvendeve, duhet të veprojnë në pajtim me kornizën juridike për shpалosjen e të gjitha aktiviteteve të planifikuara gjatë vitit fiskal.
- Sa i përket vendimmarrjes së kryetarëve të komunave, 9 komuna duhet të fillojnë me publikimin e akteve të kryetarit për të cilat legjislacioni kërkon publicitetin e tyre.
- 18% e akteve të kuvendeve të aprovuara nuk janë publikuar në ueb-faqe. Komunat duhet të shtojnë angazhimin e tyre për publikimin e këtyre akteve. Publikimi është kusht për hyrjen në fuqi dhe zbatimin e akteve në pajtim me rregullat juridike të zbatueshme.
- Raportimi i komunave duhet të jetë prioritet kryesor mbi të cilën mbështetet qeverisja e mirë dhe demokratike. Mospublikimi i raporteve të punës së 17 kryetarëve mbetet shqetësuese për transparencën e punës së tyre, sikurse mospublikimi i raporteve tremujore financiare të 14 komunave.
- Në përgjithësi komunat qëndrojnë më mirë në publikimin e dokumenteve planifikuese financiare. Megjithatë 6 komuna kërkohet të plotësojnë kushtin për publikimin e Kornizës Afatmesme të shpenzimeve.
- Referuar të dhënave të 9 komunave të cilat nuk e kanë publikuar planin e prokurimit publik, autoritetet komunale duhet të ndërmarrin veprime për bërjen publike të dokumenteve të kërkuara në këtë segment të qeverisjes.
- Njoftimet e qytetarëve për takime publike duhet të jenë konsistente dhe të shtrihen në të gjitha komunat. Sipas të dhënave, 8 komuna këtë kriter nuk e kanë plotësuar. Pavarësisht rrethanave të pandemisë Covid-19, takimet publike duhet të zëvendësohen me takime online, për të cilat duhet të shfrytëzohen të gjitha platformat e përshtatshme për njoftimin dhe prezencën e qytetarëve.

